



USHTRIA



Viti i 71-të i botimit Nr. 34 (827579)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 27 Korrik 2018

PRESIDENTJA KROATE KITAROVIC NË ANIJEN "ORIKU"



Kitarovic: Për detarët shqiptarë erëra të mbara dhe det të qetë

Gjatë vizitës zyrtare dy ditore në vendin tonë, mesditën e datës 19 korrik 2018, Presidentja kroate, Kolinda Grabar Kitarovic, zhvilloi një vizitë në anijen "Oriku", e cila ishte bregëzuar enkas për këtë vizitë në molin Nr. 8-të, të Portit të Durrësit. Fillimisht Presidenten dhe ekipin e saj shoqërues e priti Komandanti i Forcës

Detare, Gjeneralmajor Ylber Dogjani. Nga pala shqiptare zonja Kitarovic, shoqërohej nga Ministri i Transporteve dhe Energjitikës, zoti Damian Gjikhuri, Kryetari i Bashkisë së Durrësit, zoti Vangjush Dako, etj. Gjatë vizitës në anije, Presidentja kroate u takua me ekuipazhin e anijes "Oriku" si dhe kuadro të Shtabit të Forcës...

» faqe 2

OPERACIONI "SEA GUARDIAN"

Anija "Butrinti" dhe Kontingjenti i VIII-të kthehen nga deti Egje



» faqe 6

Akademia e Forcave të Armatosura Diplomohen 43 oficerë të rinj për Forcat e Armatosura

Ministrja Xhaçka: FA do mbajë të hapur portën e dijes dhe mundësinë e arsimit në Amerikë, Britani, Gjermani, Itali, Greqi, etj.

» faqe 3



Hiqen 31 predha

Operacione për heqjen e predhave në ujë

Që prej datës 18 korrik 2018, efektiva Zhytës të Qendrës së Zhytjes në Forcën Detare, janë angazhuar për kryerjen e operacioneve me qëllim heqjen e predhave në hapësirën nënujore pranë hotel "New Yorkut" në zonën e Ujit të Ftohtë, Vlorë. Gjatë këtyre ditëve, efektivat zhytës kanë arritur të heqin 31 copë predha artilerie dhe murtaje, të cilat dalin në pjesën fundore të...

» faqe 2



Bashkëpunimi

"Lissus" kryen operacionin e saj të parë në detin Egje

Ka mbërritur në detin Egje pak ditë më parë, Kontingjenti IX dhe anija "Lissus" është angazhuar në operacione të tyre të parë në ndihmë të krizës së emigrantëve. Në orët e para të mëngjesit të ditës së premte, të javës që kaloi, më datë 20 korrik, anija Lissus zbuloi në zonën e saj të operacionit një gomone me 40 persona në bord. Për rreth një orë, në bashkëpunim me Rojen Bregdetare turke dhe FRONTEX është...

» faqe 3

SPECIALE

Muzeu i Ushtrisë Shqiptare, një risi për vizitorët dhe studiuesit

ALBERT Z. ZHOLI faqe 4-5

HISTORI USHTARAKE

Historiani i parë ushtarak Dilaver Radëshi

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ faqe 6

Analizë

Qëndrimi evolues i Aleancës para dhe pas Samitit të Brukselit

» faqe 8-9



Presidentja kroate Kitarovic në anijen "Oriku"

Kitarovic: Për detarët shqiptarë erëra të mbara dhe det të qetë

Gjatë vizitës zyrtare dy ditore në vendin tonë, mesditën e dates 19 korrik 2018, Presidentja kroate, Kolinda Grabar Kitarovic, zhvilloi një vizitë në anijen "Oriku", e cila ishte bregëzuar enkas për këtë vizitë në molin Nr. 8-të, të Portit të Durrësit.

Fillimisht Presidenten dhe ekipin e saj shoqërues e priti Komandanti i Forcës Detare, Gjeneralmajor Ylber Dogjani. Nga pala shqiptare zonja Kitarovic, shoqërohej nga Ministri i Transporteve dhe Energjitikës, zoti Damian Gjikhuri, Kryetari i Bashkisë së Durrësit, zoti Vangjush Dako, etj.

Gjatë vizitës në anije, Presidentja kroate u takua me ekuipazhin e anijes "Oriku" si dhe kuadro të Shtabit të Forcës Detare e Flotiljes Detare. Nëpërmjet një brifingu të shkurtër Presidentja dhe Stafit i saj i ngushtë u njoh me historikun e Forcës Detare Shqiptare, reformat e ndërmara për modernizimin dhe shtimin e kapaciteteve operacionale të saj, bashkëpunimin me vendet aleate të NATO-s dhe Flotën Kroate në vecanti. Gjatë vizitës Zonjës Kitarovic ju dhurua stema e anijes "Oriku", të cilën ajo e mirëpriti me kënaqësi. Gjithashtu Shkëlqesia e saj falenderoi Gjeneral Dogjanin për pritjen e bërë dhe shprehu mirënjohjen për bashkëpunimin midis dy ushtrive dhe dy flotave tona. Ndërsa në librin e përshtypjeve Ajo shkroi: Ju uroj detarëve shqiptarë që nën bekimin e zotit, gjatë lundrimeve të tyre të kenë erëra të mbara dhe det të qetë. Vizita e zonjës Kitarovic u mbyll me një foto të përbashkët me kuadro dhe marinarë të Forcës sonë Detare.

Gjatë vizitës në portin e Durrësit, Presidentja Grabar-Kitarovic ka pre-



zantuar nisjen e projektit të Programit të OKB-së për Zhvillim (UNDP), e cila ka mbështetje financiare dhe nga Kroacia, për "Menaxhimin e detare dhe ndotjes bregdetare për sigurinë e zgjeruar në det në përputhje me Ligjet Detare dhe Politikën e BE-së". "Unë mendoj se është para e investuar shkëlqyeshëm. Deti është një burim i pasurisë. Është mjedisi ynë për të cilën ne të gjithë jemi përgjegjës," tha presidentja Grabar-Kitarovic. Në fjalimin e tij para të pranishmëve në prezantimin e projektit, në mesin e të cilëve ishte Ministri i Transporteve dhe Energjitikës Damian Gjikhuri, drejtor i UNDP-së në Shqipëri Eltyaebe dhe Vedran Martinić nga institucionet ATRAC, Presidentja tha se mbrojtja

e Adriatikut dhe kujdesi ndaj ndotjeve ka një rëndësi vendimtare për Kroacinë, por edhe shtetet e tjerë kanë një përgjegjësi për të vepruar së bashku, për ta mbrojtur atë. Parandalimi i një incidenti është hapi më i rëndësishëm që ne duhet të marrim për të mbrojtur zonat bregdetare të Adriatikut, tha. Sipas saj, për Kroacinë është gjithashtu e rëndësishme dhe ajo ka për qëllim që të punojë jo vetëm me Shqipërinë, por edhe Mali e Zi dhe vende të tjera në Adriatik, për menaxhimin e mbeturinave, sidomos në dimër, kur era e detit rrymat sjellin mbeturina në bregdetin kroat dhe për pastrimin e tyre duhen shumë investime dhe përpjekje.

Gjatë vizitës tre ditore, presidentja



e Kroacisë, Kolinda Grabar Kitarovic, u prit nga Presienti i Republikës dhe Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura Ilir Meta, Kryetari i Parlamentit Gramos Ruçi, Kryeministri Edi Rama, kryetarin e Bashkisë Tirane, z. Erion Veliqaj i cili i dhuroi edhe "Çelesin e qytetit". Presidentja Kitarovic ka takuar edhe shefin e Opozitës, z. Lulzim Basha.

Zonja Kitarovic ka mbajtur një falim në Parlamentin Shqiptar dhe ka zhvilluar vizitë në qytetin historik

të Beratit dhe Krujës. Në ditën e fundit të vizitës shtetërore në Shqipëri, Presidenti Grabar-Kitarovic ka vendosur një kurorë për të gjithë heronjtë kombëtarë në monumentin "Nënë Shqipëri". Presidenti Meta e vlerësoi Presidenten Kolinda Grabar-Kitarovic me "Dekoratën e Flamurit Kombëtar", u shpall "Qytetare Nderi" e qytetit të Beratit dhe ju dhurua stema e anijes "Oriku", anije e cila patrullon në detin Egje në kuadër të misionit të NATO-s.

HIQEN 31 PREDHA ARTILIERIE DHE MURTAJE

Operacione për heqjen e predhave nënujore

Që prej datës 18 korrik 2018, Qefektiva zhytës të Qendrës së Zhytjes në Forcën Detare, janë angazhuar për kryerjen e operacioneve me qëllim heqjen e predhave në hapësirën nënujore pranë hotel "New Yorkut" në zonën e Ujit të Ftohtë, Vlorë. Gjatë këtyre ditëve, efektivat zhytës kanë arritur të heqin 31 copë predha artilerie dhe murtaje, të cilat dalin në pjesën fundore të detit nga lëvizja e rërës për shkak të dallgëve të rrymave detare. Në këtë rajon është bërë disa herë pastrim i shtratit të detit nga municionet, qoftë nga zhytësit



tanë por edhe në bashkëpunim me me palën holandeze si dhe njësitë EOD të Forcave të Armatosura. Operacioni do

të vazhdojë në ditët në vijim deri në heqjen e plotë të predhave, që janë të dukshme në pjesën fundore të detit.

Anija "Mati P-02" shpëton anijen austriake me vela "S/Y Mia Hara"

Në orët e vona të mbrëmjes së të premtes, date 23 korrik 2018, në sallën operative të Forcave Detare është dhënë njoftim se në rajonin rreth 8 milje travers Gjijt të Dafinës, anija me vela "S/Y Mia Hara" me kapiten Karl Mistlberg kërkonte ndihmë pasi ishte bllokuar e nuk lundronte dot.

Në ndihmë të anijes me vela, e cila rezultoi se kishte rënë në rrjetat e një anije peshkimi, doli anija Mati P-02, që kryente shërbim gatishmërie në ishullin e Sazanit. Pas një ore anija Mati mbërriti në rajonin ku ndodhej anija me vela dhe u angazhua në operacionin për prerjen e rrjetave dhe, më pas, rimorkimin e saj, duke e shoqëruar atë për në portin e Vlorës.

U raportua gjithashtu se të katër personat që ndodheshin në bordin e anijes me vela, ishin në gjendje të mirë shëndetësore. Në mënyrë të vazhdueshme anijet e Forcës Detare janë angazhuar në operacione të ndryshme të dhënies së ndihmës në det, qoftë për persona, por dhe mjete detare në rrezik.



STAFI

DED KOLA
Shef i Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**
Albert **ZHOLI**

Gazetarë:
Saimir **ALIJA**
Ilir **LAME**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**
Redaktore/Korrektore:
Anila **DODA**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni "Skënderbej"

Akademia e Forcave të Armatosura

Diplomohen 43 oficerë të rinj për Forcat e Armatosura

Ministrja Xhaçka: FA do mbajë të hapur portën e dijes dhe mundësinë e arsimimit në Amerikë, Britani, Gjermani, Itali, Greqi, etj.

Në ambientet e Muzeut të Forcave të Armatosura të RSH, u zhvillua paraditën e datës 20 korrik ceremonia e diplomimit të 43 oficerëve të rinj, të cilët përfunduan Kursin e Arsimimit të Përgjithshëm të Oficerit në Akademinë e Forcave të Armatosura. Në këtë ceremoni ishin të pranishëm Ministri i Mbrojtjes zj. Olta Xhaçka, anëtarë të Komisionit të Sigurisë, ZV/SHSHPFA Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu, komandantët e forcave, gjeneralë, drejtorë drejtorish në MM dhe SHP, si dhe familjarë të kadetëve.

Në fjalën e rastit, Komandanti i KDS, Gjeneral Brigade Prof. Asoc. Bajram Begaj, u shpreh: “Sot është një ditë e shënuar për mbarë FA dhe në veçanti për ju oficerë të rinj, pasi shënon kapërcimin e madh që ju bëtë, duke kaluar nga jeta civile duke iu bashkuar trupës së oficerëve të Forcave tona të Armatosura. Formimi dhe arsimimi i oficerëve të rinj është konsideruar gjithmonë si në sfidë transformuese për t’iu përshtatur sa më mirë ndryshimeve sociale, teknologjike dhe ushtarake. Synimi ynë i përbashkët, ka vijuar gjeneral Begaj, - është që oficeri i ardhshëm duhet të jetë i aftë për të drejtuar nënrepartet e repartit në misionet luftarake dhe jo luftarake të FA brenda dhe jashtë vendit; të kryejë me integritet detyra luftarake dhe jo luftarake me nivel të lartë vështirësie në kuadër të Aleancës; të integrojë vlerat më të mira të shoqërisë në fushën e mbrojtjes dhe, të përçojë karakterin dhe vlerat më të mira të FA në shoqërinë civile; të ketë ndjenjë të lartë integriteti, vetëmohim e besnikëri, nismë e përgjegjësi, ndershmëri dhe respekt, për eprorët dhe vartësit në kryerjen e detyrave të ngarkuara; të kërkojë dhe marrë përgjegjësi në detyrën që kryen; të zotërojë konceptet, teknikat fundamentale ushtarake dhe të kuptojë taktikën dhe doktrinën ushtarake”.

Gjeneral Begaj, falenderoi të gjithë stafin akademik për impenjim maksimal në mësimdhënie e trajnim, vlerësoi ndihmë e pakursyer të MM, për përmbyshjen e objektivave dhe realizimin me sukses të gjithë procesit të përgatitjes së oficerëve të rinj, falenderoi familjarët e kadetëve si dhe duke përfunduar fjalën e rastit, iu uroi suksese të mëtejshme kadetëve të sapo diplomuar, si pjesë e gjeneratës së FA.

Një përshëndetje e veçantë të oficerëve të sapo diplomuar, u është adresuar nga MM, zonja Olta Xhaçka, e cila pasi shprehu kënaqësinë e marrjes pjesë në këtë ceremoni shumë të veçantë, u shpreh ndër të tjera: “karriera e ushtarakut është një karrierë plot sakrificë edhe kufizime, por sigurisht për një mision shumë të rëndësishëm, ndoshta misionin më të rëndësishëm që kemi të gjithë bashkë që është siguria e qytetarëve shqiptar dhe siguria e atdheut tonë të përbashkët. Porta që ju po kaloni sot, ka vijuar ministria Xhaçka, nuk është e vetmja, por është porta kryesore prej ku ju do të vijoni rrugëtimin drejt thellimit të njohurive ushtarake. Forca e Armatosur, do ta mbajë të hapur portën drejt dijes dhe do t’iu japë juve dhe çdo të riu sikundër ka bërë përgjatë këtyre viteve, mundësinë e arsimimit më tutje në akademitë më prestigjioze të aleatëve tanë si në Amerikë, në Britani, në Gjermani, në Itali, në Greqi, etj., për t’u kthyer më pas në përfaqësuesit më të denjë të Shqipërisë krahas mijëra efektivëve nga vendet aleate të familjes së madhe euro-atlantike. Dhe ne të gjithë së bashku do jemi garantët e ëndrrës për të qenë imazhi i sigurisë së vendit tonë”.



tha në fjalën përshëndetëse ministria Xhaçka. Ministria Xhaçka bëri të ditur se studimi në akademitë perëndimore u jep mundësi të rinjve të kthehen më pas në përfaqësuesit më të denjë të Shqipërisë krahas mijëra efektivëve nga vendet aleate të familjes së madhe Euro-Atlantike. Duke iu drejtuar prindërve të 43 kadetëve të sapo diplomuar, ministria e Mbrojtjes tha: “Shumë prej jush, me të drejtë mund të ngrenë pikëpyetje mbi të ardhmen e fëmijëve tuaj, të sapo diplomuar si oficerët më të rinj të ushtrisë shqiptare. Ju siguroj se secili prej jush duhet të ndihet krenar për vajzat dhe djemtë tuaj nën uniformë, kur t’i shikoni ata, duke përfaqësuar vendin në vendet anëtare të NATO-s. Kam këtu parasysh, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përfaqësitë tona diplomatike, përfaqësimin në komandat e Aleancës në Bruksel, apo në Northfolk, apo dhe në misione të ndryshme të paqes për të përçar vlerat më të mira të

Forcave tona të Armatosura. Do të jeni krenarë për fëmijët tuaj jo vetëm si oficerë me armë, por edhe si financiarë, si pedagogë, si mjekë, si juristë, si komandantë, si pilotë, si detarë, të ardhshëm, pse jo edhe si gjeneralë apo si shefa Shtabi”.

Ndërsa renditi emrat e të gjithë atyre personalitetëve që kanë dalë nga radhët e kadetëve ndër vite, ministria Xhaçka u shpreh: “Jam këtu sot, edhe në cilësinë e ministres së Mbrojtjes, për t’ju dhënë garanci që këto hapësira që krijohen në FA janë plotësisht të mundura, të prekshme dhe të arritshme, për këdo që ka zgjedhur të bëjë karrierë dhe t’i përkushtohet Forcës tonë të Armatosur”. Në emër të oficerëve të rinj, përshëndeti kadete Erjona Zogaj, e cila duke mos fshehur emocionet e kësaj dite të veçantë dhe pasi falenderoi të gjithë për mbështetjen, u shpreh ndër të tjera se: “Rrjedha e jetës që kemi ndërruar kërkoi shumë përgjegjësi

dhe përkushtim të veçantë, duke marrë me vete sfida dhe përgjegjësi të mëdha, për të demonstruar vullnetin dhe aftësinë tonë për të qënë ushtarakë të denjë e të përkushtuar për ti shërbyer vendit tonë. Pjesëmarrja e 12 femrave ndër 43 veta, tregon guximim dhe iniciativën e femrave për të qënë pjesë e një strukture që nga mentaliteti i mëparshëm apo tabuve është konsideruar si i papërshtatshëm apo i papërbalueshëm nga gjinia

femërore. Diplomimi i sotëm tregon krejt të kundërtën, fakt që përbën një shëmbull unik inkurajimi mbi pjesëmarrjen e femrave në FA”, përfundoi kadete Zogaj.

Më tej, ceremonia vijoi me shpërndarjen e diplomave si dhe certifikatave të vlerësimit për kadetët me rezultatet më të mira. Oficerët e graduar ndoqën për 24 javë Kursin e Përgatitjes së Oficerëve të rinj, pranë Forcave të Armatosura të RSH-së.

“Lissus” kryen operacionin e saj të parë në detin Egje

Ka mbërritur në detin Egje pak ditë më parë, Kontingjenti IX dhe anija “Lissus” është angazhuar në operacione të tyre të parë në ndihmë të krizës së emigrantëve. Në orët e para të mëngjesit të ditës së premte, të javës që kaloi, më datë 20 korrik, anija Lissus zbuloi në zonën e saj të operacionit një gomone me 40 persona në bord. Për rreth një orë, në bashkëpunim me Rojen Bregdetare turke dhe FRONTEX është bërë e mundur kryerja e operacionit për marrjen e emigrantëve nga gomonia në anijen e FRONTEX, nga ku u proçedua më tej për sa i përket gjendjes së tyre shëndetësore dhe dorëzimit pranë autoriteteve vendore në Çesme. Kontingjenti IX dhe anija “Lissus” u bë pjesë e operacionit “Sea Guardian” në detin Egje më datë 19 korrik dhe do të jenë aty përkatësisht për një periudhë për gjashtë muaj.



Muzeu i Ushtrisë Shqiptare, një risi për vizitorët dhe studiuesit

Albert Z. ZHOLI

Ekam pasur ëndërr të vizitoj Muzeun e Armëve dhe të Luftës në Stamboll. Është qyteti që shtrihet në dy kontinente, Europë-Azi, ndaj duke marr parasysh dhe krijimin e tij, mund të themi se ai mbetet qyteti më mistik i botës, për pozicionin gjeografik, perandoritë që kanë drejtuar në këtë qytet për mëse 2000 vjet, për muzetë më të veçantë të si Muzeu Ushtarak. Këtë ëndërr e realizova në vitin 2015. Është vërtetë një muze befasues. I ndërtuar në pjesën europiane, në verilindje të Stambollit, ky muze për çdo ditë pret mbi 2 mijë vizitorë nga shumë vende të botës. Gjatë gjithë kohës që është i hapur, ky muze me një sipërfaqe 1 mijë metër katror nuk njihet qetësi. Ndërtesa është prej guri, dy katëshe dhe ka brenda saj 16 pavione interesante që të mbajnë gjallë kërshërinë deri në fund të vizitës. Edhe në sheshet përreth muzeut janë vendosur sende dhe armë të ndryshme luftarake nga më befasueset, që e bëjnë edhe më tërheqës këtë muze krejt specifik. Sipas specialistëve ku muze ka përbrenda një pasuri dhe shumëllojshmëri koleksionesh që të lënë me gojë hapur. Më kryesorja është se në botën e organizimit të muzeumeve, Muzeu Ushtarak, jo në kuptimin modern daton në shekullin e 15. Pikërisht zanafilla e tij nis pas pushtimit nga turqit në vitin 1453 të Stambollit. Në këtë kohë gjenden dhe armët më të çmuara të luftës. Mjetet dhe mbledhja e furnizimeve të Muzeut Ushtarak (Shtëpi Cebeh) ka marrë rrugë dhe formë të plotë në vitin 1726. Themeli i muzeut në kuptimin modern, i përket armaturave të hedhura nga dhëndëri i Ahmed Fethi Pashës hedhur në vitin 1846. Kjo mënyrë ndërtimi me armaturë cilësohet si kompania e parë në kuptimin e ndërtimit modern të muzeve turke. Muzeu Ushtarak ka një sallë të madhe veprimtarish. Veprat e ekspozuara janë zgjedhur me kujdes nga mbi 45.000 sende dhe objekte dhe me rreth 5000 vepra. Në të gjen

Pjesë e këtij muzeu janë rreth 6500 objekte, ku 1500 janë me vlera muzeale të veçanta dhe të vendosur nëpër tre pavijone



armë nga periudha të ndryshme, veshje ushtarake, tenda, flamuj dhe parulla me një lloj të ngjashme janë të përfshira në asete të ndryshme kulturore ushtarake. Këtu përfshihen pushkë të bukura prej druri dhe stolisje metali, armë, topa dhe shpata, dekorata elegante dhe mbishkrimet me forca të blinduara, mburoja dhe helmata, të cilat janë një nga shembujt e rrallë të ushtrisë osmane ku në funksion të natyrës së artë të Perandorisë nxjerrë në pah madhësinë e pallatit Osmane Tombac tendë.

Pavijonet

Muzeu Ushtarak në Stamboll ka 16 pavijone, njëri më magjepsës se tjetri, mbushur plot armatime dhe sende ushtarake me shumë vlerë dhe që i përgjigjen periudhave të ndryshme të Perandorisë Osmane. Kam shkruar gjatë për këtë muze ndaj sot dua të përcjell të veçantat e një Muzeu tjetër të këtij lloji, Muzeun e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë që ka të veçantat dhe risitë e veta duke e krahasuar me atë të Stambollit.

Muzeu i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë

Aktualisht, në kryeqytetin tonë funksionojnë dhe janë të hapur për vizitorët, por edhe për studiuesit disa muze, si Muzeu Historik Kombëtar, Muzeu Arkeologjik i Tiranës, Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe", muzeu i Fakultetit të Biologjisë dhe të tjerë. Në mesin e këtyre muzeve bën pjesë edhe një muze i veçantë dhe i mirëorientuar, funksional, i quajtur Muzeu i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Pjesë e tij janë objekte, teknika luftarake, armë, mjete të blinduara, zjarrfikëse, avionë, helikopterë, stacione radiolokative, raketa, tanke, autoblanda, topa kundërajrorë dhe bregdetar, pajisje të ndryshme ushtarake, armë dhe mjete teknike të specifikuara, uniforma, por edhe dokumente dhe simbole të përdorura nga Forcat e Armatosura të Shqipërisë në periudha të ndryshme historike.

Vendndodhja

Muzeu i Ushtrisë së Shqipërisë ndodhet në territorin e garnizonit "Skënderbeu" pranë godinës së Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë në Tiranë. Ky garnizon me një histori mbi 80-vjeçare, dallohet për ambientet e pastërta, të gjelbra, dhe mirëmbajtjen e tyre. Rregulli, siguria dhe harmonia e ndërtesave, arkitektura e vecantë tregojnë për një punë vizionare dhe ide që formëson një vijueshmëri harmonie për ti mbijetuar në mënyrën më të bukur kohës. Ky institucion ka tërhequr vëmendjen dhe interesin e qytetarëve në Shqipëri, në veçanti të veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, ushtarakëve aktivë e në rezervë, historianëve, studiuesve, kërkuesve shkencorë, studentëve dhe nxënësve por edhe qytetarëve të thjeshtë për vetë specifikën por edhe të veçantat që nuk gjenden në muzetë e tjerë. Pas përmirësimit të muajve të fundit, publikimit dhe inaugurimit të "Pavijonit të Skënderbeut", ku mori pjesë dhe ministrja Xhaçka, e cila ishte nismëtarja e këtij pavijoni, tashmë për muzeun e FA-së kanë shfaqur interes edhe turistët, vizitorët dhe studiuesit huaj. Në Muzeun e FA janë ekspozuar mes të tjerash dhe 3600 objekte me vlera muzeale specifike ushtarake, i cili vazhdon të pasurohet në vijimësi me objekte të ndryshme. Ekspozimi dhe trajtimi i ekspozateve në pavijonet e muzeut bëhet përmes metodave, teknikave dhe teknologjive bashkëkohore të realizuara me një skenografi, dekor, ndriçim dhe ruajtje me kulturë të lartë profesionale dhe bashkëkohore. Sipas drejtorit të Muzeut të Forcave të Armatosura, Asllan Zemani, Muzeu i FA është më unikali dhe i vetmi i këtij lloji në vendin tonë dhe shumë shpejt do të licensohet, duke u bërë Muze Kombëtar. Sipas Zemanit, Muzeu i FA është në funk-

sion të vizitorëve vendas dhe të huaj të cilët muajt e fundit e kanë rritur së tepërmi interesin e tyre për këtë muze të rrallë. "Ky është një muze specifik dhe i veçantë dhe jemi munduar ta popularizojmë. Vizitorët kryesisht janë nga vendet anëtare të NATO-s. Ne festa të ndryshme kombëtare e kemi mbajtur hapur që ta vizitojnë edhe të huajt nga vende të ndryshme. Vizitorët janë nga Turqia, Danimarka, Holanda, Polonia dhe nga vendet e Ballkanit, që kanë shfaqur interes ose mendime për bashkëpunime dhe shkëmbime të ndryshme për objektet", tregon Zemani.

Si është organizuar muzeu i FA?

Muzeu i Forcave të Armatosura të Shqipërisë (MFA) është muze tipologjik dhe pasqyron ngjarjet më të rëndësishme ushtarake, vlerat më të mira ushtarake, të trashëguara nga kombi ynë gjatë gjithë historisë së tij në shekuj. Në këtë muze janë të pasqyruara të gjitha periudhat e shtetit shqiptarë dhe në thelb shpreh identitetin, kujtesën dhe progres-zhvillimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Në esencë ai shpreh identitetin, kujtesën dhe progres-zhvillimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ideja për ndërtimin e Muzeut të FA ka filluar herët por është vënë në zbatim me urdhrin e ministrit, nr. 252, datë 04.06.2010. Në vitin 2012 u rikonstruktua godina që ndodhet në territorin e garnizonit "Skënderbej", Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes duke e kthyer atë për funksione muzeale. Muzeu i FA ndodhet në territorin e garnizonit "Skënderbej", Tiranë. Muzeu i Armëve (Muzeu Historik i Forcave të Armatosura) ndodhet në ambientet e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (ish- Shkolla e Bashkuar). Ky muze u ngrit me rastin e 100-vjetorit të themelimit të ushtrisë shqiptare. Ai përmban objekte muzeore të rralla, ku dallohen pisqolla që nga Mesjeta deri në shekullin XIX, kobure të dekoruara me ar e argjend, një sërë vitrinash me pushkë të llojeve të ndryshme të Mesjetës, të Rilindjes, shpata të kohës së Skënderbeut, tejqyra e Ali Pashë Tepelenës. Pjesë e këtij muzeu janë rreth 6500 objekte, ku 1500 janë me vlera muzeale të veçanta dhe të vendosur nëpër tre pavijone. Muzeu është i konceptuar me katër pavijone: pavijoni i hollit qendror; pavijoni i viteve 1470-1945, pavijoni i viteve 1945-1990 dhe ekspozime të objekteve jashtë godinës së muzeut.

Pavijoni i Hollit Qendror

Sa afrohesh pranë muzeut shikon një ndërtesë të madhe ngjyrë gri dhe me kornizat e dritareve të lryera me të





bardhë. Një pastërti që të qetëson sytë. Në qendër të godinës, përballesh me derën kryesore që të çon tek pavijoni i hollit qendror. Një derë e thjeshtë, ku shkallët e vogla ngjithëse janë shtruar me qilim të kuq. Në hollin qendror, në hyrje të katit të parë të godinës janë 92 objekte. Raketa K/A SAM-2, uniforma dhe armatime personale si dhe 11 flamuj me vlera historike të periudhës nga vitit 1884 deri në vitin 1920. Flamuri i Shoqërisë "Drita" 1884, flamuri i varrimit të Ismail Qemalit, flamuri i Qeverisë së Vlorës i vitit 1913, flamuri i Princ Vidit, viti 1914 (i vogël), flamuri i Princ Vidit, viti 1914 (i madh), flamuri i Shoqërisë "Djelmënia e Stambollit", 1 gusht 1919, flamuri i Bandës "Vatra, flamuri i përdorur në festimet e çlirimit të Vlorës, viti 1920, flamuri i Ushtrisë Shqiptare "Batalion Sulmues", flamuri i Kongresit të Lushnjës dhe flamuri i Ushtrisë Shqiptare "Nënreparti 6". Dhoma e ushtarit me pajisjet dhe koleksion me kartolina. Në katin e dytë të godinës janë ekspozuar 20 objekte: panorama të ndryshme me uniforma të Ushtrisë Shqiptare në periudhën e pavarësisë deri në vitin 1924. Shpata "ujku që turret", shpata me këllëf e dorezë bronz, shpata me këllëf metalik, shpata të përziera (me dhe pa këllëf) si dhe uniformat e reja të FA për këmbësorinë, Forcat Detare, Forcat Ajrore, uniformë bande muzikore dhe uniformë të forcave speciale.

Pavijoni i viteve 1470-1945

Në këtë pavijon janë ekspozuar 300 objekte muzeale ku përfshihet periudha e Skënderbeut, Mesjetës, Rilindjes, periudha e Pavarësisë, dhe ajo e Luftës së Parë e të Dytë Botërore. Periudha e Skënderbeut ka bustin prej bronzi, topuzë origjinal, shpata origjinale, hark druri, heshta druri imitacion, gjyle guri të mëdha dhe të vogla të përdorura me katapultë. Periudha e Mesjetës ka jataganët e shekullit të XVI, topin reliq të Tafil Buzit (periudha e Tanzimatit), pushkë "Karafile" me strall të mesjetës, shpata lufte dhe ceremoniale të shekullit XVI-XIX, top i rëndë dhe i mesëm i periudhës së mesjetës. Armët e shekullit



të XVII-XIX janë pushkë me mbushje baruti nga lart, e veçantë është një pushkë e rëndë që në atë periudhë ka shërbyer për pengimin e kundërshtarëve në hyrje të kështjellave. Periudha e Rilindjes ka pushkë të prodhimit italian, anglez, gjerman dhe austriak. E veçanta e kësaj periudhe është sepse u kalua në mbushjen e pushkëve me barut nga lart. Një element tjetër i veçantë i kësaj periudhe janë dhe dylbitë e kohës së Ali Pashë Tepelenës. Periudha e Pavarësisë ka pishqolla e kobure artizanale të përdorura nga prijësit shqiptarë në shekullin e XVII-XIX, mbushës e kuti baruti, pushkë të periudhës së pavarësisë, prodhim gjerman, anglez, italian, austriak, ku veçojmë pushkën dhe revolverin italian me mulli të përdorur në këtë periudhë. Një vend të veçantë në këtë pavijon zënë dhe fotot e "Marubit" në të cilat janë pasqyruar luftëtarë shqiptarë me kostumet e armët e ekspozuara nga të gjitha trevat e Shqipërisë. Periudha e Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore ka të ekspozuara top K/A 20 mm prodhim italian, top i 100 mm, prodhim rus të përdorur në Luftën e Parë Botërore, mortaja 40 mm dhe mitraloza të përdorur në Luftën e Parë e të Dytë Botërore.

Pavijoni i viteve 1945-1990

Në këtë pavijon janë ekspozuar 3200 objekte me vlera muzeale. Disa nga objektet kryesore në këtë pavijon janë pistoletat të llojeve të ndryshme të prodhimit gjerman, turk, italian, rus, kinez të përdorura në FA, pushkë, automatik, mitraloza të kalibrave e

municione të ndryshme të vendosura në arka ambalazhi, granata dore KK e KT, komplet minakërkues, elementë të drejtimit të zjarrit KA, raketa KA, pajisje të shëndetësisë, radiozbulimit dhe aparaturo të ndërlihdjes. Pajisje logjistike si gaveta, pagurë, lugë, pjata alumini, pajisje të mbrojtjes kundër-kimike, aparat të ndryshëm degëzues,



llojeve të ndryshme, municionet dhe pajisjet e këtyre armëve, granatahedhëse kundërtank 40 mm, mortaja 60 mm dhe 82 mm, raketa kundërajrore, armë dhe

komplet të MKK, kundërgaz të llojeve të ndryshme, kundërgaz për kuajt, FHL; në sektorin e xhenios, komplet minakërkues, mina KK dhe KT metalike e bakeliti, mina surprizë, aparate minaplasëse, komplet çminimi, etj. Në sektorin e Forcave Detare, objekte si kostum polumbari, spirancë, fener orientues deti, makete anije luftarake dhe nëndetëse, etj. Në sektorin e Forcave Ajrore, maket kabinë avioni "Mig-19", helikopter "Mi-8", etj.

Ekspozime në oborrin e madh të muzeut

Një ambient i veçantë, i sistemuar në funksion të muzeut duke u shkrirë "organikisht" me tre pavijonët e brendshëm. Mes gjelbërimit dhe kornizimit të vendosjes së objekteve ka një vendosje elegante që të tërheq pa vetëdije.

Konkretisht në sheshin jashtë godinës së Muzeut (ose pavijonit në hapësirë) të FA janë vendosur 43 objekte me vlera muzeale, teknike luftarake të llojeve e kalibrave të ndryshme, avionë, tanke, transportues i blinduar, artileri tokësore të kalibrave të ndryshëm nga 75 mm deri 152 mm, maket katërsiluruesi, artileri kundërajrore të kalibrave të ndryshëm, helikopterë, mortaja, mitralozë të lehtë dhe të rëndë, mitraloza kundërajrore, makina radiozbuluese, automjete transportuese trupash dhe mjedesh luftarake dhe shumë materiale të ndryshme luftarake.

Epilog

Kur largohesh nga vizita që i bën MFA, merr me vete një pjesë të madhe të historisë shqiptare, mbresa, ngjarje që nuk i kishe imagjinuar më parë. Me të vërtetë Muzeu i FA, tashmë është një thesar ende i pazbuluar për pjesën dërrmuese të popullit, por edhe për studiuesit, historianët, dhe vizitorët e huaj. Në disa aspekte ai mund të krahasohet edhe me Muzeun e Luftës në Stamboll, dhe këtë e them me shumë përgjegjësi. Aty gjen me paanësi ngjarjet më të rëndësishme ushtarake dhe vlerat më të mira të trashëguara nga kombi ynë gjatë historisë së tij në shekuj të cilat janë të pasqyruara me shumë profesionalizëm. Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka në ditën e promovimit të pavijonit të Skënderbeut e cilësoi këtë muze një thesar ende të pazbuluar, pasi studentët e akademive ushtarake të profileve të ndryshme si dhe nxënësit e shkollave të të gjitha niveleve do të gjejnë kushte të përshtatshme jo vetëm për vizitë por edhe për të ndjekur zhvillimin e orëve mësimore për ngjarjet me karakter ushtarak dhe historik. Muzeu i FA tashmë është në funksion të vizitorëve vendas dhe të huaj dhe ka zgjuar ndjeshmërinë dhe ka tërhequr vëmendjen e qytetarëve në veçanti veteranë, ushtarakë aktivë e në rezervë, historianë, studiues, kërkues

shkencorë, trupa pedagogjike, studentë, nxënës dhe të tjerë. "Armatime historike, pajisje të rralla dhe mjete nga 105 vjet ushtri do t'ju kthejnë prapa në kohë për të përjetuar nostalgji dhe për të ndërjerë krenari", shkruan ministrja Xhaçka në një postim në rrjetet sociale shoqëruar edhe me disa foto nga ky muze i veçantë historik. Duke lexuar fjalët e ministres Xhaçka të thëna me sinqeritet dhe krenari, mund të them se kushdo që e ka vizituar, apo ka dëshirën, apo ka planifikuar për ta vizituar këtë Muze, patjetër do largohet me përshtypjet më të mira, por dhe me dëshirën e madhe për ta vizituar përsëri. MFA është një vlerë e shtuar e muzeumeve shqiptare që tashmë është kthyer në një thesar që e lartëson historinë, kulturën por mbi të gjitha lartëson cilësitë dhe virtytet më të larta të popullit tonë në shekuj.



Historiani i parë ushtarak

DILAVER RADËSHI



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Dilaver Radëshi në ajkën e rinisë shqiptare

Dilaver Radëshi (Sulçe) ka lindur më 22 dhjetor të vitit 1922 në fshatin Radësh të Skraparit, në familjen e njohur të Hysen Sylçes. Në Radësh kreu shkollën fillore dhe shkoi në armatosur, ku mbante në brez jataganin e gjysh Hysenit të famshëm, të "Hysenit me pallë".

Dilaver Radëshi arriti të ndërmerre lëvizje e veprime që e çuan tek ajka e rinisë shqiptare, e cila po luftonte të merrte në dorë fatet e atdheut. Në vitin 1939 vendi u pushtua nga fashistët italianë dhe fashistët rekrutuan mjaft të rinj, duke i futur në garnizonet e famshme të "balilëve". Dilaverie 18 vjeçar shërbeu si rojë kufiri në disa pjesë të Shqipërisë sin ë peshkopi, Shëngjin dhe Durrës deri në vitin 1942. Dilaverit ju kërkua të mohonte flamurin e vendit, kujtoi mësuesin e shkollës fillore të fshatit, patriotin Nure Dobrusha, i cili i kishte folur me shumë dashuri për Atdhenë dhe flamurin e Skënderbeut që nuk do ta harronte kurrë, gjë që u bë shkak për të dezertuar nga ushtria. Me krijimin e çetës së Skraparit, mësues Nuren do ta kishte bashkëluftëtar dhe kështu u bë edhe Dilaveri pjesë e luftëtarëve të Çetës së Skraparit.

Partizani që u plagos katër here

Me krijimin e Brigadës së I-rë Sulmuese, më 15 gusht të vitit 1943 në Vithkuq të Korçës, luftëtari nga Radëshi i Skraparit u gjend në radhët e saj si partizan i thjeshtë. Në luftimet që zhvilloi Brigada e I-rë Sulmuese Dilaver Radëshi u plagos katër herë. Dilaver Radëshi e nisi partizan i thjeshtë i skuadrës së sulmit, ku komandant të skuadrës së sulmit kishte "Heroin e Popullit" Hekuran Pobrati. Këta trima e burra të guximshëm kishte në krah Dilaver Radëshi.

Në luftimet që zhvilloi Brigada e I-rë Sulmuese në krahinën e Mal-lakastrës si në Ballsh, Patos, Symizë, Gllavë etj., Dilaver Radëshi ka treguar kujdes, ka mbajtur shënime, si dhe ditar, ku dora e partizanit i ka shkruar nën krismat e armëve të pushtuesit. Më 10 Djetor të '43 më thërret Mehmet Shehu, shkruan ai në ditar, dhe më jep detyrë të ndaloj në prapavijën e armikut, për të mbledhur informata rreth tij bashkë me Qemal Kalenjën, Ibrahim Zoton e Axhem Abazin. Armiku ndodhej kudo dhe kishte filluar terrori. Ishin pushkatuar 11 këshilltarët e Hekalit. Këtu, në një bazë, takuam edhe Bilbil Klosin. Me ne erdhi dhe një fshatar, Dino Drizari, njeri shumë guximtar."



Duke e parë e ndjekur hap pas hapi luftëtarin skraparas komandanti i brigadës, Mehmet Shehu, kur mbritën në Skrapar, në fshatin Vërzehzhë në shkurt të vitit 1944, e ngarkoi me detyrën e zëvendëskomandantit të Batalionit të Dytë. Ishte vetëm 22 vjeç.

Në një prej komunikatave të muajit Nëntor të vitit 1944, pas çlirimit të Tiranës nga Brigada e I-rë Sulmuese dhe formacionet e tjerë partizane, u gjet vendi të shkruhej edhe për Dilaver Radëshin. Ja ç' shkruhet në komunikatë, përmbajtjen e të cilës na i sjell mësues Neim Mustafaraj në librin "Radëshi, tre mijë vjet histori": "Në këto veprime luftarake vlen të përmendët heroizmi i komandantit të Batalionit të Dytë të Brigadës së I-rë Sulmuese, i cili ndodhet në vijën e parë të luftës dhe plagoset për të katërtën herë. Pushka e Dilaver Radëshit u dëgjua në të gjitha betejat luftarake që zhvilloi brigada. Gjithë efektivit i strukturave që drejtoi Dilaveri, nga ushtarit më i thjeshtë e deri tek kuadrot e shokët e tij më të afërt, e ndejnë nga afër kujdesin prej shoku e vëllai që ai tregonte për secilin".

Në vitin 1945, caktohet në krye të një brigade tjetër sulmuese, në Br. XI S, me detyrën e nënkomandantit. Gjatë luftimeve u plagos për të katërtën herë.

Në studime gjithmonë shkëlqyeshëm

Në vitin 1945 i doli e drejta për të studiuar e përgatitur për pilot në një nga

Këtë detyrë e kreu deri në vitin 1955. Dilaver Radëshin në vitin 1955 shkoi për të studiuar në Akademinë "Frunze", të cilën e përfundoi me rezultate të shkëlqyera.

Me përfundimin e studimeve u emërua pedagog i historisë të artit ushtarak në Shkollën e Lartë të Oficerëve. Në këtë periudhë studioi dhe përfundoi me nota shumë të mirë Institutin e Historisë në Universitetin e Tiranës. Ai kreu mjaft detyra nga më të ndryshmet, por rezultat dha në punën me Historinë Ushtarake që ishte dhe pasioni i tërë jetës së tij. Në këtë sector punoi në shkolla ushtarake, në degën e Historisë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Drejtorinë Ushtarako-Shkencore të ushtrisë.

Në rrugën e studimeve të historisë ushtarake

Dilaveri studio dhe paraqiti tema të rëndësishme të historisë së vendit, të cilat kishin rëndësi të jashtëzakonshme. Ai studio në mënyrë të posaçme historinë e Skënderbeut, gjë për të cilën shkoi deri në Stamboll dhe në Romë, për të zbuluar e publikuar dokumente rreth kësaj figure historike kombëtare të popullit shqiptar. Për figurën e Skënderbeut mbajti leksione, përgatiti dhe botoi artikuj në organe shkencore, përgatiti libra, por që nuk u botuan, për shkak të kthesës që mori jeta e tij.

Në librin e tij "Inkursioni i Brigadës së Parë Sulmuese", të botuar në vitin 1963, Dilaveri ka shkruar gjatë, ka përshkruar në detaj veprimet luftarake të Brigadës së I-rë, por të veçanta janë dy rreshta: "Lufta filloi. Terreni ishte i thyer, mali i mbuluar me dëborë. Sulmoheshim nga armiku nga poshtë lart".

Atë e tërhoqën betejat e Skënderbeut kundër pushtuesit osman, duke kryer studime nëpër arkiva, në literaturë dhe u ndal kryesisht te betejat e parë dhe fitimtare e Torviollit. Kjo betejë ishte e rëndësishme dhe përcaktuese për fatin e Ushtrisë së Lidhjes së Lezhës dhe të vetë Skënderbut, si kryekomandant i kësaj ushtrie. Meriat e autorit qëndronte në faktin se ai e zhvilloi këtë betejë, tabllon e saj, në një trajtë më të plotë, jo vetëm në

pikëpamje të përshkrimit me ngjyra të gjalla, të plota dhe të besueshme, por më tepër për analizën dhe evidentimin e elementeve të artit taktike të skemave orgjinale që Skënderbeu me komandantët e tij zbatoi me sukses në fushën e luftës, duke e drejtuar me siguri në fitore.

Në vitin 1967, kur u ndërmerre një lëvizje për të kryer reforma të thella në ushtri, Dilaver Radëshi doli kundër tyre dhe si studiues e ushtarak me shkollë, kërkonte modernizimin e ushtrisë dhe jo kopjes të rëndomtë, që nuk kishin lidhje me ushtrinë shqiptare. E ngriti zërin. Bëri letra ku sillte agumente, ndërmerri lëvizjen e fundit duke i shkruar Enver Hoxhës. Me mendje studiuesi, njohës i artit ushtarak, luftëtar që mbante mbi shpatulla përvojën e luftës, nuk u dëgjua kurrë.

Përsëri leksione në ambientet ushtarake dhe vlerësime

Dragoi i Skraparit Dilaver Radësh, ushtaraku i zot që dinte të thoshte se zemra ime është vetëm e imja, nuk u gjynjëzuar. E dënuan me burg, e syrgjynosën këtë njeri që mbante jataganin e gjyshit sa ishte çilimi për t'i shërbyer vendit të tij, fillimisht në burgun e Burrelit ku qëndroi 10 vjet, që u pasua më 13 vjet të tjerë internimi në fshatin Kajan të Belshit, një jetë 23 vjet vuajtjesh. Në një ditë e qershorit të vitit 1993, në Akademinë e Mbrojtjes në Tiranë, në një nga sallat e saj u mbajt një leksion mbi betejën e parë të skënderbeut, e quajtura dhe e mirënjohura Beteja e Torviollit. Referusi ishte Dilaver Radëshi, mbante leksion pas më shumë se 20 vitesh të mohuar mungese në auditoret ushtarake. Dilaver Radëshi për shërbimet ndaj atdheut, si patriot e luftëtar, është nderuar me rreth 13 urdhëra, medalje e dekorata. Zemra e tij pushoi më 6 tetor të vitit 1996, në moshën 74 vjeçare. Kështu u mbyll jeta e këtij luftëtari atdhetar, e ushtarakut, e studiuesit të pasionuar të historisë ushtarake. Pas vdekjes është dekoruar "Medaljen e Artë të Shqiponjës", akorduar nga Presidenti i Republikës në 5 Shtator të vitit 2002.



Operacioni "Sea Guardian"

Anija "Butrinti" dhe Kontingjenti i VIII-të kthehen nga deti Egje

Tashmë kemi riafirmuar prezencën e Forcës Detare shqiptare në detin Egje, si pjesë e Grupit të Dytë Detar të NATO-s

Paraditen e datës 24 korrik 2018 në Bazën Detare Pashaliman, Vlorë, u zhvillua ceremonia e pritjes së Kontingjentit VIII dhe anijes Butrinti, që e mbylli me sukses misionin e saj 6-mujor në përbërje të Grupit të Dytë Detar të NATO, si pjesë e operacionit "Sea Guardian", në detin Egje. Në ceremoni mori pjesë zëvendëskomandanti i Forcës Detare, kapiten i rangut të parë Subi Zenelaj, komandantë të reparteve vartëse, kuadro dhe detarë të Flotiljes Detare, familjarë të efektivave të kontingjentit të tetë, si dhe media të ndryshme.

Fillimisht, zëvendëskomandanti në emër të forcës i uroi mirëseardhjen kontingjentit VIII, duke shprehur mirënjohje ndaj punës dhe përkushtimit të tyre. Ndër të tjera ai tha: "Për të gjithë ju, ky mision ishte një eksperiencë e vyer dhe sot le ta quajmë përfundimin e tij një moment të rëndësishëm, pasi tashmë jeni pranë njerëzve tuaj të dashur".

Më tej ai shtoi "Falë punës tuaj edhe të kontingjenteve të tjera, tashmë kemi riafirmuar prezencën e Forcës Detare shqiptare në detin Egje, si pjesë e Grupit të Dytë Detar të NATO, duke kontribuar përkrah aleatëve në krizën e emigrantëve dhe duke patur rol të konsiderueshëm". Kontingjenti VIII ishte nën komandën e kapiten të rangut të tretë Taulant Bako dhe shërbeu tre muaj në operacionin "Sea Guardian" me po të njëjtën detyrë si kontingjentet e tjera, patrullimin në zonën e përgjegjësisë dhe ndërhyrjen në rastet kur rrezikohen jetët njerëzore. Anija Butrinti u zëvendësua në operacionin e NATO në detin Egje nga simotra e saj Lissus dhe Kon-



tingjenti IX shqiptar, i cili u dislokua në zonën e tij të përgjegjësisë disa ditë më parë. Pjesëmarrja e Forcës Detare në operacionin "Sea Guardian" si pjesë

përbërëse e Grupit të Dytë Detar të NATO, ka filluar në nëntor të vitit 2016 me anijen "Oriku", për t'u pasuar nga "Butrinti" dhe tashmë "Lissus".



Nga Shefqet Kërçelli

Lamtumirë Komandant Aleko Kosta Pojani

Kam përshtypjen se ai po përpqet të më thotë diçka që unë s'po e përkthej dot në mendjen time. Si një shigjetar me sy të mbyllur unë po mundohem të gjuaj sa më shumë shigjeta, me shpresën se do të godas në shenjë. Si do të shnerrohet Gjermania, në qoftë se Trump-i e shkëput Amerikën nga NATO? Kissingeri e pëlqen këtë pyetje, por refuzon të hamendësojë sa janë gjasat për një skenar të tillë. “Në fund të viteve '40 të shekullit të shkuar, liderët europianë kishin qartësi në busullën e tyre, ndërsa sot thjesht duan të shmangin trazirat,” thotë ai. “S'po ia dalin t'i shmangin,” e ndërpres unë. “E vërtetë,” përgjigjet Kissingeri me një nënqeshje misterioze. “Një gjerman i shquar më tha para pak kohësh, se e kishte pas parë tensionin me Amerikën si një shkak për t'u shkëputur prej saj, ndërsa tani është i frikësuar nga një largim i Amerikës nga Europa”. A do mund ta shkundë Trump-i Perëndimin, në mënyrë që të mbahet me këmbët e veta, e pyes unë. “Do të ishte një e papritur nëse ndodh kjo gjë, por nuk është edhe e pamundur,” përgjigjet Kissingeri.

“Një Atlantik i përçarë do ta shndërronte Europën në shtojcë të Euroazisë, e cila do të jetë nën mëshirën e Kinës,” vazhdon ai. Sipas tij, Kina synon të rikthehet tek roli i saj historik që pati gjatë kohës së Mbretërisë së Mesme. Më tej ajo do që të jetë prijësja e gjithë njerzimit. Nga mënyra si flet, duket se Kissingeri beson se Kina është në rrugë e sipër për arrijtjen e këtij objekti. Sipas tij, një largim i Amerikës nga Europa do ta shndërronte atë vetë në një ishull gjeostrategjik, të rrethuar nga dy

oqeane dhe pa një rend botëror demokratik për të mbrojtur.

Një Amerikë e tillë do t'i ngjante Britanisë viktoriane, por pa mundësinë për ta përçarë pjesën tjetër të botës, siç bëri Britania me kontinentin europian.

Tani ka ardhur koha për kafën. Pas drekës unë marr një dopio ekspreso, ndërsa Kissingeri merr një çaj menteje. Vendos të gjuaj edhe një shigjetë të fundit të drejtëpërdrejtë. I them: “Shpesh njerzit të kritikojnë, ngaqë aftësinë për të patur akses tek njerzit më të fuqishëm në botë e paguan me mosfoljen hapur në publik rreth tyre. A është tani çasti më së fundi, që t'i djegësh disa ura që të lidhin me njerzit e fuqishëm?” Kissingeri preket nga kjo pyetje.

Pas një pauze përgjigjet: “E kam në mendje këtë gjë dhe shumë miq të ngushtë më nxisin ta bëj. Mund të ndodhë një ditë.” Nuk ka kohë më të përshtatshme se sot, i them me një buzëqeshje nervoze. “Është i qartë destinacioni final i asaj që kam në mendje, a është i qartë për ty?” më pyet. Jo dhe aq, i përgjigjem. “Ti je i shqetësuar për të ardhmen? Ti mendon se ekziston probabiliteti që Trump-i ta trembë aq shumë Perëndimin, sa ky i fundit të rishkruajë rregullat e rendit botëror, të cilat i kemi marrë si të mirëqena deri më sot? A është pak a shumë kjo gjëja që ke në mendje?” e pyes.

“Mendoj se jemi në një situatë shumë, shumë të rëndë për botën,” përgjigjet Kissingeri. “Unë kam zhvilluar shumë takime diplomatike të nivelit më të lartë, por ata [njerzit e Trump-it] nuk më morën mend për këtë të Helsinkit.”

Është e qartë tashmë se nuk do ta zgjasë më këtë temë. E pyes se me cilën periudhë të historisë do ta krahasonte këtë të sotmen. Ai fillon flet për kohën kur sapo kishte marrë nënshtetësinë amerikane dhe kishte shkuar në luftë. Gjithashtu kujton edhe shkakun pse kishte emigruar në Amerikë. Pasi Gjermanët marshuan në Austri më 1938, çifutëve iu dha udhë të rrinin mbyllur në shtëpi. Prindërit e tij u arratisën kur mundën. “Ishte një përvojë traumatike që s'më është shqitur nga mendja,” thotë ai mendueshëm.

Një kujtim i zgjedhur me kujdes.

***Autor i librit “Zbythja e Liberalizmit Perëndimor”**



Përse nuk donin vendet fqinje Teutën e Ilirisë?

Teuta qe një personalitet i rëndësishëm i historisë Ilire. Sundoi vetëm për 3 vjet, por vepra dhe lavdia e kësaj gruaje ka triumfuar në shekuj.

Teuta, si një grua e zgjuar dhe largpamëse, nuk pëlqej nga shtetet fqinje.

Duke parandjerë rrezikun e një pushtimi, ndërmori dhe realizoi një veprimtari të gjithanshme politike, ushtarake e diplomatike. Ajo u përpoq për të afruar aleatë (siç ishte formimi i marrëdhënieve me Maqedoninë) për të përballuar opozitën e brendshme dhe kërcënimet e jashtme. Ndërkohe edhe strategjikisht, ajo punoi për të zbutur armiqësitë e mbretërve të veçuar dhe, përgjithësisht, për të shuar rivalitetet e grupeve shoqërore të armatosura brenda mbretërisë.

Me këtë vije dinamike dhe elastike, mbretëresha-stratege e rriti prestigjin, shëndoshi pozitën në gadishull e Adriatik dhe përgatiti terrenin e opinionin për hapa dhe aksione të reja.

Për të ndaluar marrjen e territoreve të Ilirisë dhe tkurrjen e shtetit ilir në një hapësirë të cinguar, Teuta e shkallëzoi fushatën ushtarake. Me shpinë të sigurt dhe krahun lindor aleat, ajo u vu në krye të ekspeditës së dytë ushtarake ilire kundër Lidhjes Epirote në jug si rreziku më urgjent. Ajo frymëzoi dhe komandoi me sukses ushtrinë e flotën. Kryeqyteti epirot, Foinika (Finiqi i sotëm, afër Sarandës), që dallohej si më i pasuri midis qyteteve të Epirit, ra në duart e ushtrisë ilire.

Ajo hipi në pushtet në një moment të vështirë për popujt ilirë, të cilët përballëshin me ambicet për zgjerim të Republikës Romake, paçka se gjendja ekonomike e zotërimeve të saj ishte e mirë.


Vijoi me planet dhe synimet e Agronit, përforcoi me tej rendin shtetëror, duke i dhënë përparësi pushtetit qendror, u dha impuls të ri zhvillimit ekonomiko-kulturor të qyteteve, si bazë themelore për një stabilitet dhe fuqizim në fushën ushtarake. U bë kujdes që të mos cenoheshin kufijtë e mëparshëm të mbretërisë (që shtriheshin nga Vjosa në Naron, përveç Durrësit, Apollonisë dhe Lezhës, që ende mbaheshin si koloni nga romakët).

Vëmendjen kryesore ia kushtoi ushtrisë dhe sidomos flotës se fuqishme detare, jo më të vogël sesa ajo para saj. Dhe për këtë Teuta urdhëroi:

“Prijësit ta konsiderojnë armik gjithë bregdetin”.

Kështu, liburnët e flotës ilire bënin ligjin në Adriatik. Një shtet i përqendruar dhe me pretendimet e veta në të drejtë, me një fuqi detare që sfidonte deri në hyrje të Mesdheut, nuk mund të pranohej, qoftë edhe në heshtje, nga shtetet që e kufizonin Ilirinë.





Përmes një prezantimi informues, shefi i Departamentit për Operacione dhe Trajnime i KFT-së koloneli Fadil Hoxha e njohu gjeneralin Hoffmann me misionin, strukturën, kapacitetet, aktivitetet, detyrat dhe ndihmën që NALT-i në vazhdimësi i ofron FSK-së. Më pas gjeneralët Cikaqi dhe Hoffmann vizituan Shtabin e Forcave Tokësore dhe njësitë ku po zhvillohet procesi i punës së përbashkët rreth planifikimit të aktiviteteve dhe trajnimeve për vitin 2019.



SHEFI I SHTABIT TË KFOR-IT NË KOSOVË

Gjeneral brigade Lawrence R. Powell në Komandën e Doktrinës (KDS)

Më 19 korrik 2018, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) gjeneral brigade Irfete Spahiu priti shefin e Shtabit të KFOR-it në Kosovë gjeneral brigade Lawrence R. Powell. Në takimin e përbashkët në mes të dy gjeneralëve u bisedua për bashkëpunimin e dyanshëm ndërmjet FSK-së dhe KFOR-it, me theks të veçantë për bashkëpunimin në fushën e stërvitjes dhe shkëmbimit të përvojave.

Gjeneral Spahiu dhe gjenerali Powell biseduan edhe për të arriturat e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe rolin e KDS-së në zhvillimin dhe profesionalizimin e pjesëtarëve të FSK-së, si dhe

mundësitë e bashkëpunimit si brenda ashtu edhe me partnerët strategjikë, si dhe për objektivat për zhvillimin dhe avancimin e KDS-së në të ardhmen.

Gjeneral Spahiu ka falënderuar gjeneralin Powell për bashkëpunimin e deritashëm dhe për ndihmën që KFOR-i ka dhënë dhe po jep për Kosovën si dhe kontributin në ndërtimin dhe zhvillimin e FSK-

së, si me pajisje po ashtu edhe me trajnime. Ajo gjithashtu e njoftoi gjeneralin Powell edhe me zhvillimet e përgjithshme që janë duke ndodhur në KDS dhe synimet për të ardhmen. Takimi përfundoi me shkëmbimin e dhuratave mes gjeneralëve të cilët shprehën gatishmërinë që bashkëpunimi të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Togeri Alban Ajevazi, studenti më i mirë ndërkombëtar në SHBA

Oficeri i Forcës së Sigurisë të Kosovës, togeri Alban Ajevazi, këshilltar ushtarak i komandantit të Forcës Tokësore të FSK-së, shpallet studenti më i mirë ndërkombëtar, në trajnimin “Kursi për Kapiten të Karrierës për Adjutant Gjeneral” që u realizua nga shkolla e Adjutantëve Gjeneralë të Ushtrisë së SHBA-ve. Në këtë shkollë, përveç studentëve nga ushtria amerikane, pjesëmarrës ishin edhe oficerë nga Kosova, Egjipti, Jordania, Indonezia dhe Rumania. Në vlerësimin e përgjithshëm nga ushtria amerikane shkruhet: Togeri Alban Ajevazi demonstroi një kuptim të plotë të kompetencave të burimeve njerëzore, si dhe funksioneve të tjera thelbësore të mbështetjes së burimeve njerëzore. Ai e përfaqësoi Kosovën në mënyrë të jashtëzakonshme në Shtetet e Bashkuara.

Toger Ajevazi, gjatë shkollimit në SHBA, ka zgjeruar njohuritë ushtarake në temat e përgjithshme si: Menaxhimi i sistemeve të burimeve njerëzore; mbështetja operacionale dhe taktike; shërbimet esenciale dhe menaxhimi i gatishmërisë së personelit; zhvillimi i planifikimit dhe operacioneve në kuadër të burimeve njerëzore dhe mbështetja civile në operacione. Togeri i FSK-së, Alban Ajevazi, në shkollën e Adjutantëve Gjeneralë të Ushtrisë së SHBA-ve arriti rezultate të shkëlqyeshme dhe si rezultat i performancës së lartë, pas përfundimit të trajnimit, u dekorua me medaljen „Diplomatic Award” për periudhën kohore janar-korrik 2018.



DREJTORI I EKIPIT NDËRLIDHËS KËSHILLËDHËNËS TË NATO-S (NALT)

Gjeneral brigade Ralf Hoffmann viziton komandën e Forcës Tokësore

Më 20 korrik 2018 në mjediset e kazermës „Adem Jashari” të Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi priti në takim drejtorin e Ekipit Ndërlidhës Këshillëdhënës të NATO-s (NALT) për MFSK/FSK-në, gjeneral brigade Ralf Hoffmann.

Gjeneral Cikaqi e informoi drejtorin e NALT-it, gjeneralin Hoffmann, për aktivitetet që po zhvillohen në kuadër të Komandës së Forcave Tokësore. Ata diskutuan edhe lidhur me ndihmën që NALT-it po ofron për FSK-në me këshillime, rekomandime dhe trajnime. Po ashtu folën për të arriturat e FSK-së dhe mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen të FSK- me NALT-in, për çka gjenerali Hoffmann u shpreh i gatshëm që ky bashkëpunimi do të vazhdojë edhe në të ardhmen.



Përmes një prezantimi informues, shefi i Departamentit për Operacione dhe Trajnime i KFT-së koloneli Fadil Hoxha e njohu gjeneralin Hoffmann me misionin, strukturën, kapacitetet, aktivitetet, detyrat dhe ndihmën që NALT-i në vazhdimësi i ofron FSK-së. Më pas gjeneralët Cikaqi dhe Hoffmann vizituan Shtabin e Forcave Tokësore dhe njësitë ku po zhvillohet procesi i punës së përbashkët rreth planifikimit

të aktiviteteve dhe trajnimeve për vitin 2019. Në kuadër të kësaj vizite, gjenerali Hoffmann, gjithashtu takoi edhe dy sindikatat, Sindikatën e Personelit dhe Sindikatën për Politikë dhe Plane të KFT-së. Në fund, në emër të stafit të Komandës së Forcave Tokësore gjeneral Cikaqi e falënderoi gjeneralin Hoffmann për vizitën dhe për kontributin e çmuar të ekipit që ai drejton.

Një delegacion i FSK-së vizitë në Ministrinë e Jashtme të Francës

Zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK) z. Burim Ramadani, komandanti i FSK-së gjeneraljejtënant Rrahman Rama dhe oficeri i lartë kolonel Jeton Dreshaj, ishin për vizitë zyrtare më 19 korrik në Republikën e Francës. Delegacioni i MFSK-së i shoqëruar edhe nga ambasadori i Republikës së Kosovës në Paris z. Qëndrim Gashi u prit nga z. Thomas Bertin, drejtor për Ballkanin Perëndimor në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Francës. Në takimet që zhvilloi delegacioni i FSK-së në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në Ministrinë e Mbrojtjes të Francës, janë diskutuar arritjet e FSK-së, bashkëpunimi dypalësh dhe avancimi i marrëdhënieve ndërmjet dy ministrive. Zëvendësministri Ramadani dhe gjenerali Rama në takimet e tyre me zyrtarët francez biseduan edhe për sigurinë në Kosovë dhe rajon, si dhe për të ardhmen e FSK-së dhe mundësitë që FSK-ja në të ardhmen të bëhet pjesë e Operacioneve Paqeruajtëse krahas ushtrive të vendeve të NATO-s. Në të gjitha takimet e delegacionit të MFSK-së me zyrtarët francez u arrit konstatimi se bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Francës për çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes është kontribut për partneritetin e përgjithshëm midis dy vendeve si dhe për sigurinë rajonale dhe më gjerë.



Krahas kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e veçanta: të mos të kenë marrë masë ndalese për kryerje të profesionit, aktivitetit apo detyrës; të plotësojnë kriteret e sigurisë sipas Ligjit për Informata të Klasifikuara, që i vërteton shërbimi përkatës në Ministrinë e Mbrojtjes dhe me sukses të kenë kaluar testin për aftësi fizike me Test- program për kontrollimin e aftësive motorike të studentëve/kadetëve dhe të studentëve të programeve të akredituara studimore në ciklin e parë të studimeve në Akademi.



Akademia Ushtarake „Gjeneral Mihailo Apostollski“

Hapet konkursi për vitin akademik 2018-2019

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme si: të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë; të kenë kryer maturën shtetërore, të jenë deri në 21 vjeç, etj.

Më 25 korrik 2018, sipas nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit për Akademinë Ushtarake- “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 83/2009, Akademia Ushtarake „Gjeneral Mihailo Apostollski“- Shkup ka shpallur konkursin për regjistrimin e studentëve/kadetëve për nevojat e Ministrisë së mbrojtjes dhe Armatës së Republikës së Maqedonisë në ciklin e parë të studimeve në Akademinë Ushtarake „Gjeneral Mihailo Apostollski“- Shkup për vitin akademik 2018/2019

Akademia Ushtarake “Gjeneral Mihailo Apostollski”-Shkup shpall Konkurs për regjistrimin e studentëve/kadetëve për nevojat e Ministrisë së mbrojtjes dhe Armatës së Republikës së Maqedonisë në ciklin e parë të studimeve në Akademinë Ushtarake për 25 kandidatë edhe atë: Studimet e ciklit të parë të studimeve organizohen sipas programeve studimore të akredituara me ligj, normativa, standarde dhe metodologji të pranuar nga hapësira e vetme Evropiane për arsim të lartë, të vlerësuara me kredi sipas EKTS-së. Programet studimore të ciklit të parë të studimeve në Akademi përmbajnë 240 kredi dhe zgjasin katër vite. Çdo vit në programin studimor përmban 60 kredi.

Të drejtë pjesëmarrjeje në konkurs kanë kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e përgjithshme: të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë; të kenë kryer maturën shtetërore, maturë ndërkombëtare, maturë shkollore në arsimim gjimnazi apo të kenë dhënë provimin e arsimimit profesional të mesëm në kohëzgjatje katër vjeçare; mos të jenë më të moshuar se 21 vjeç në ditën e aplikimit dhe dorëzimit të dokumenteve dhe të jenë të aftë psikofizikisht (vërtetohet përmes komisionit ushtarako-mjekësor).

Krahas kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e veçanta: të mos të kenë marrë masë ndalese për kryerje të profesionit, aktivitetit apo detyrës; të plotësojnë kriteret e sigurisë sipas Ligjit për Informata të Klasifikuara, që i vërteton shërbimi përkatës në Ministrinë e Mbrojtjes dhe me sukses të kenë kaluar testin për aftësi fizike me Test- program për kontrollimin e aftësive motorike të studentëve/kadetëve dhe të studentëve të programeve të akredituara studimore në ciklin e parë të studimeve në Akademi

Kandidatët shtetas të Republikës së Maqedonisë që kanë kryer arsimin e mesëm në Republikën e Maqedonisë apo një pjesë të arsimit të mesëm jashtë shtetit, si dhe kandidatët të cilët kanë mbaruar maturën ndërkombëtare, regjistruan në kushte të barabarta dhe kriteret e ciklit të parë të studimeve. Gjatë përzgjedhjes së kandidatëve për shkollim në Akademi mbahet llogari për përfaqësim përkatës dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive etnike dhe zhvillim të perspektivës gjinor, duke



respektuar parimet e profesionalizmit dhe kompetencave.

Në pajtim me Ligjin për të drejtat e veçanta të pjesëtarëve të forcave të sigurimit të Republikës së Maqedonisë dhe të anëtarëve të familjeve të tyre, fëmijët e pjesëtarit të vvarë apo të ndjerë të forcave të sigurimit dhe fëmijët e invalidit të luftës nga grupi I deri VII invaliditet të luftës do të kenë përparësi gjatë regjistrimit në Akademinë, me kusht që ti plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta, si dhe të plotësojnë minimum pikë të vërtetuara në Konkurs.

Gjatë përzgjedhjes së kandidatëve për regjistrim të ciklit të parë në Akademinë Ushtarake “Gjeneral Mihailo Apostollski”-Shkup, vitin akademik 2018/2019 krahas kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta merren parasysh kriteret e mëposhtme: suksesi përgjithshëm i kandidatëve në të gjitha lëndët të arritur në arsimin e mesëm; suksesi i maturës shtetërore; suksesi nga provimi i realizuar pranues nga matematika; suksesi i provimit të realizuar me shkrim nga gjuha angleze dhe suksesi i arritur nga testi i aftësive fizike.

Vlerësimi i kriterëve shprehet me pikë. Numri maksimal i pikëve që kandidati mund ta fitojë sipas të gjitha kriterëve është 100 pikë. Suksesi i përgjithshëm i kandidatëve në të gjitha lëndët, i arritur në arsimin e mesëm merr pjesë me më së shumti 35 pikë.

Në suksesin e përgjithshëm të arritur në arsimin e mesëm, si kriter për regjistrim, shtohet: suksesi i maturës shtetërore ose maturës ndërkombëtare, me më së shumti 25 pikë; suksesi i provimit pranues nga lënda e matema-

tikës, me më së shumti 15 pikë; suksesi i provimit pranues nga gjuha angleze, me më së shumti 15 pikë; suksesi nga kontrollimi i përgatitjes fizike vlerësohet me më së shumti 10 pikë.

Vlerësimi i suksesit në arsim të mesëm bëhet si vijon: mbledhen të gjitha notat e dëftesave nga të gjitha vitet, shuma e fituar ndahet nga numri i notave dhe kështu mesatarja e fituar shumëzohet me 7. Në këtë mënyrë mund të merren maksimum 35 pikë. Kandidatët e interesuar për pranim në Akademinë Ushtarake për vitin akademik 2018/2019 mund të aplikojnë në afatin e parë regjistruar deri më datë 15 dhe 16.08.2018, prej orës 8,30 deri në ora 16,30 Nëse në afatin e parë pranues nuk plotësohet numri i planifikuar i kandidatëve, Akademia Ushtarake do të organizojë një afat të dytë regjistrimi më datën 11.09.2018.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme: lutje, që merret në Akademinë Ushtarake; aplikacionin që merret në Akademinë Ushtarake; dëftesa për të gjitha katër vitet e shkollës së mesme në origjinal; diplomë për provimin e maturës shtetërore në origjinal; certifikatë shtetësie në origjinal; certifikatë të lindjes në origjinal; vërtetim nga gjyqi përkatës se nuk është marrë masë sigurie si ndalesë për kryerje profesioni, vepriktarie ose detyre. vërtetim nga mjeku amë për gjendjen e përgjithshme shëndetësore të kandidatit.

Pas përcaktimit të listave për paraqitje, kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit do të thirren për të testuar aftësitë psikofizike dhe gjendjen fizike dhe për dhënien e provimeve pranuese për matematike dhe gjuhë angleze.

DREJTORIA FRANCEZE E ARMËVE

Mundësi bashkëpunimi për industrinë ushtarake

Mbi bazën e programit të bashkëpunimi dypalësh për vitin 2018 me Ministrinë e Mbrojtjes të Francës, para pak ditëve zhvilloi një vizitë pune në Maqedoni një delegacion francez i drejtosisë së Armatimit.

Gjatë qëndrimit në Maqedonisë, delegacioni i kryesuar nga ambasadori i Republikës së Francës në Republikën e Maqedonisë Timonie dhe atasheu ushtarak i mbrojtjes kolonel Jean-Marc Lavallée, u takuan me Zëvendës Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Armatës së Maqedonisë, Gjeneral Major Azim Nouredin dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes e Shtabit të Përgjithshëm të ARM-së.

Gjatë takimit delegacioni francez ka paraqitur kapacitetet e industrisë së armëve të Francës dhe me këtë rast shprehë mendime dhe ide për një bashkëpunim të mundshëm sipas nevojave dhe prioritetëve të Ushtrisë të Maqedonisë.

Gjatë vizitës delegacioni francez ka vizituar kompanitë industriale maqedonase “Evrokompoziti” dhe “Mikroskop” në Prilep, ku ata kanë shkëmbyer përvojat në fushën e industrisë ushtarake, si dhe kanë parë mundësitë për të filluar një bashkëpunim në mes të kompanive franceze dhe artyre të Maqedonisë.

GJENERAL NOUREDIN PRET AMBASADORIN DHE ATASHEUN USHTARAK

Kolonel Duda atashe ushtarak jorezident i Francës në Maqedoni

Zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Armatës së Maqedonisë, Gjeneral Major Azim Nouredin u takua me ambasadorin e Francës në Republikën e Maqedonisë HE krishterë Timonie dhe kolonel Fabrice Duda, i sapo emëruar atashe ushtarak jorezident i Francës i akredituar në Maqedoni.

Takimi u përqëndrua në mundësitë për zgjerimin e bashkëpunimit dypalësh ndërmjet ARM-së dhe Forcave të Armatosura Franceze dhe pjesëmarrjen e mundshme të përbashkët në operacionet paqeruajtëse të udhëhequra nga Organizata e Kombeve të Bashkuara.

Në takimin protokollar të zhvilluar në Shtabin e Përgjithshëm të ARM-së, gjenerali Nuredin përgëzoi kolonelin Duda për emërimin e detyrës së re, që e ka qëndrën në Zagreb, Kroaci,

Me këtë rast, gjenerali Nuredine shprehu mirënjohje ndaj kolonelit Jean Marc Lavalle i cili deri tani ishte atashe ushtarak jorezident i Francës i akredituar në Maqedoni.


GJENERAL NOUREDIN PRET KOLONELIN MINEO YAMAGUCHI

Maqedoni-Japoni: Bashkëpunim midis ushtrive të të dy vendeve

Zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Armatës së Maqedonisë, Gjeneral Major Azim Nouredin zhvilloi një takim pune të protokollar me kolonelin Mineo Yamaguchi, Atasheun e sapo-emëruar të Mbrojtjes të Japonisë, të akredituar në Republikën e Maqedonisë.

Në takim, gjenerali Nuredin përgëzoi kolonelin Mineo Yamaguchi për emërimin e detyrës së tij të re. Takimi u përqëndrua në mundësitë për intensifikimin e bashkëpunimit dypalësh midis ushtrive të të dy vendeve.

Gjenerali Nuredin falënderoi kolonelin Taki Yoshimada, Atasheun aktual të Mbrojtjes të Japonisë në Republikën e Maqedonisë për bashkëpunimin, të cilin ai e kryer që nga qershori 2015 me seli në Vienë.



“Si ministër i mbrojtjes puna ime është për ti siguruar këta njerëz që të shkojnë në një mision, të jetë të përgatitur mirë, të jenë të mbështetur me mjete të blinduara dhe të të kthehen të gjallë dhe të shëndetshëm”. Kontingjenti i Bullgarisë në Afganistan përfshin element kombëtar, një kompani ushtarësh për mbrojtje, një ekip prej këshilltarësh dhe oficerë shtabi në shtabin e misionit të NATO-s.



MINISTRI I MBROJTJES KARAKACANOVI:

Ushtarakët në Afganistan me vlerësime të larta nga partnerët

Kthehet nga Afganistani kontingjenti i 35-të i ushtrisë bullgare i përbërë nga 158 ushtarakë

Misioni i kontingjentit 35-të ishte i suksesshëm, dhe unë shpresoj se edhe kolegët e tyre do të kthehen në të njëjtën mënyrë, me nderime”, tha më 23 korrik, ministri i Mbrojtjes i Bullgarisë Karakacanovi në aeroportin e Sofjes duke pritur kontingjentin e 35-të të misionit të NATO-s në Afganistan. I gjithë kontingjenti prej 158 ushtarësh u kthye në Bullgari, pak ditë para se Kontingjenti i 36-të mirrte detyrat në misionin “Mbështetje vendimtare”. Në aeroport ishte edhe Zëvendës Shefi i Mbrojtjes, Admiral Emil Evtimov dhe Komandanti i Forcave të Përbashkëta të Komandës gjenerallejtënant Lupço Todorov.

“Partnerët tanë mendojnë se ushtarët tanë kanë një përgatitje shumë të mirë”, tha ministri i Mbrojtjes Karakacanov dhe theksoi se një mision i tillë në një vend si Afganistani është plot me rreziqe. “Unë jam i lumtur që të gjithë ata që janë kthyer nga Afganistani janë të gjallë dhe të shëndetshëm. Kjo ishte dëshira ime, kur ata i dërguam për mision për më shumë se gjashtë muaj”, tha ai dhe shtoi: “Si ministër i mbrojtjes puna ime është për ti siguruar këta njerëz që të shkojnë në një mision, të jetë të përgatitur mirë, të jenë të mbështetur me mjete të blinduara dhe të të kthehen të gjallë dhe të shëndetshëm”.

Kontingjenti i Bullgarisë në Afganistan përfshin element kombëtar, një kompani ushtarësh për mbrojtje, një ekip prej këshilltarësh dhe oficerë shtabi në shtabin e misionit të NATO-s

Komandanti i Kontingjentit është



Koloneli George Margitin, komandant kompanie për siguri është Major Stefan Dimov dhe zv/komandant Kolonel Kamen Ivanov.

Ndërkohë zëvendësministri i Mbrojtjes Atanas Zaprjanov dhe Zëvendës Shefi i Mbrojtjes Admiral Emil Evtimov kanë pritur në mënyrë

solemne, ditën e enjte, në datë 26 korrik padite, në Sheshin “Liria”, kontingjentin e 35-të Forcave të Armatosura të Republikës së Bullgarisë, i cili përfundoi me sukses pjesëmarrjen e saj në misionin e NATO-s në Afganistan “Mbështetje vendimtare”.



Avionët ushtarakë nuk transportojnë imigrantë ilegalë

“Sipas Agjencisë së Statistikave ka një ulje drastike të refugjatëve, të cilët janë me banim në Bullgari”, thotë zëvendëskryeministri dhe Ministri i Mbrojtjes i Bullgarisë, z.Krasimir Karakaçanov. Gjatë janarit të vitit 2015 kapaciteti i qendrave ka qenë i mbushur 67%. Gjatë nëntorit të vitit 2016 ka qenë 103%. Kurse gjatë korrikut të vitit 2018 ka qenë 11%. “Njerëzit, të cilët kanë hyrë në vendin tonë në periudhën 2015-2018, janë kryesisht nga Afganistani, Iraku dhe Siria”, tha Karakaçanovi. Karakaçanovi i përcaktoi “si të falsifikuara lajmet” të cilët janë paraqitur në rrjetin sociale si dhe informacionin se “me avionë ushtarakë në vend transportohen fshehurazi imigrant ilegal”.



Forcat Tokësore shkatërrojnë municionet e gjetura

Një formacion modular i Forcave Tokësore kanë shkatërruar më 21 korrik 2018, një granatë dore WG-42/ofensive afër fshatit Malorad, të rrethit Vratsa. Grupi i azgjësimit të municioneve përbëhej nga dy ushtarë dhe një veturë i cili funksionon në përbërja e Batalionit të 10-të të mekanizuar në Vratsa dhe udhëhiqet nga i oficeri Zamfirov. Municioni në fjalë është shkatërruar në vend, duke respektuar me rreptësi të plotë masat e sigurisë.

INSTITUTI HOLANDEZ I STUDIMEVE DETARE

Studime klimatike në pellgun e Detit të Zi


Anija kërkimor shkencore holandeze “Pelagija” hyri në akuatorinë e Bullgarisë për të realizuar një ekspeditë oqeanografike. Qëllimi është të grumbullohen të dhëna për ndryshimet klimatike në pellgun e Detit të Zi gjatë 20 000 viteve të fundit. Kjo do të lejojë parashikimin më të mirë të motit. Studimet do të realizohen nga 16 deri më 22 gusht me ndihmën e Institutit Holandez të Studimeve Detare. Për palën bullgare në ekipin studimor do të përfshihet bashkëpunëtori i vjetër Ljubomir Dimitrov nga Instituti i Oqeanologjisë pranë Akademisë Bullgare të Shkencave.

Ndërkohë Kuvendi Popullor miratoi më 19 korrik projektin e përditësuar të qeverisë për “Blerjen e një anijeje multifunktionale modulare të patrullimit për Forcat Ushtarako-Detare”. Projekti që i deponuar nga kabineti në fillim të



këtij muaji dhe parashikon blerjen e dy anijeve për arritjen e ndërveprimit të forcave detare bullgare me ato të vendeve të tjera nga NATO-ja dhe Bashkimi Evropian. Me aktualizimin, vlera e prognozuar maksimale e projektit që rritur në 984 milionë leva ose 503 milionë euro. Një vit më pare, më 30 maj 2017, mbledhja e Këshillit Konsultativ të Sigurisë Kombëtare u shpreh për zbatimin e përsheptuar të projekteve të modernizimit; “Plani Zhvillimor i Forcave të Armatosura deri në vitin 2020” dhe

“Programi për zhvillimin e aftësive mbrojtëse të Forcave të Armatosura të Republikës së Bullgarisë deri në vitin 2020” për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e aftësive mbrojtëse të Marinës. Qëllimi i projektit ishte blerja e dy anijeve patrulluese multifunktionale modulare me aftësi për të marrë pjesë në një gamë të gjerë të operacioneve detare të NATO-s dhe Bashkimit Evropian. Ata duhet të zëvendësojnë disa nga anijet të cilat janë prodhim rus dhe nuk janë të modernizuara.



Kryeministri Marković theksoi se Mali i Zi vlerëson mbështetjen e Hungarisë kur është fjala për integrimin e Malit të Zi në BE dhe gatishmërinë për të ndihmuar në nivelin e ekspertëve dhe për të ndarë përvojat e tyre. BE është një përparësi absolute, një qëllim strategjik që është plotësisht i angazhuar dhe i rëndësishëm për ne dhe për Evropën.



Dushko Marković-Viktor Orban

Orban: NATO garanci për të ardhmen e Malit të Zi

Orban: “Ju keni zgjedhur një organizatë për veten tuaj, por edhe për të ardhmen. Ne jemi pjesë e asaj të ardhme, ne jemi hungarezë, sepse ne jemi gjithashtu anëtare e NATO-s”.



rajonale dhe më të gjerë globale”.

Mali i Zi mirëpret interesin e Hungarisë për të nxitur rritjen e investimeve hungareze në Malin e Zi. “Investitorët hungarezë janë të mirëpritur, Mali i Zi është çdo ditë e më shumë tërheqës për kompanitë nga e gjithë bota dhe veçanërisht kur miqtë tanë dhe partnerët, të tilla si Hungaria, që njohin dhe dinë se si të përdorin investimet në interesin e përbashkët”, tha kryeministri i Malit të Zi, Dushko Marković. Ndërkohë kryeministri hungarez Viktor Orban përgëzoi Malin e Zi për anëtarësimin në NATO dhe shtoi: “Ju keni zgjedhur një organizatë për veten

tuaj, por edhe për të ardhmen. Ne jemi pjesë e asaj të ardhme, ne jemi hungarezë, sepse ne jemi gjithashtu anëtare e NATO-s. Unë shoh mundësi reale për Malin e Zi që shpejt të bëhet një anëtar e BE-së. Mund të them me përgjegjësi se Mali i Zi është në thelb gati për anëtarësim në Bashkimin Evropian”. Kryeministri i Hungarisë Viktor Orban tha se në bisedimet zyrtare është folur edhe migrimin dhe se: “Në qoftë se ju keni probleme me emigrantët, Hungaria është e gatshme për të ndihmuar, sepse kur Mali i Zi është i mbrojtur në kufijtë e saj, ai edhe Hungarinë dhe të gjithë BE-ja”.

KONFERENCË RAJONALE

Mali i Zi do kontribuojë në misionet ndërkombëtare

Në bashkëpunim me Divizionin e NATO-s dhe ALFA Center u organizua më 19 korrik në Podgoricë, Konferenca Rajonale “Një për të gjithë, të gjithë për një”. Në Konferencë ishin së bashku përfaqësues të institucioneve shtetërore të rajonit, shteteve anëtare të NATO-s nga: Shqipëria, Kroacia, Mali i Zi, përfaqësues të autoriteteve legjislative, qeveritë lokale dhe shoqërisë civile nga Mali i Zi. Gjatë konferencës, u diskutuan gjithashtu përfundimet nga samiti në Bruksel. Në Konferencë mori pjesë kreu i Drejtorisë për NATO dhe BE, Radmila Perovic. Si një nga pjesëmarrësit në panelin me temën e mekanizmave të mbrojtjes së përbashkët, Perovic theksoi se me anëtarësimin e Malit të Zi në NATO, jemi të përkushtuar në mënyrë të qartë për të kontribuar në sistemin e mbrojtjes kolektive, sepse NATO është garantuesi më i madh dhe i vetëm i sigurisë kolektive. Ajo shtoi se anëtarësimi i Malit të Zi në komunitetin Euroatlantik është një privilegj, por edhe një detyrim shtesë dhe nxitje për të kryer detyra të dedikuara me agjendën e NATO-s për të përmirësuar sektorin e mbrojtjes. Në këtë kontekst, Perovic tha se një vit pas anëtarësimit në NATO, Mali i Zi është përkushtuar për të arritur nivelin e shpenzimeve të mbrojtjes në shumën prej 2% të PBB-së, ose 20% e buxhetit të mbrojtjes për modernizimin dhe pajisjeve, që u formalizua me Planin Kombëtar për të investuar në mbrojtje për periudhën 2018-2024, miratuar nga Qeveria e Malit të Zi në nëntor të vitit të kaluar. Arritja e këtyre kritereve buxhetore të miratuara nga aleatët e NATO-s në samitin në Uells, në vitin 2014, bëjnë që Mali i Zi të investojë në kapacitetet e saj për të përmirësuar më tej sektorin e mbrojtjes, tha Perovic. Duke folur në lidhje me përfitimet që Mali i Zi ka pas anëtarësimin në NATO, Perovic ka folur për mbrojtjen e hapësirës ajrore të Malit të Zi (Policimit në ajër), e cila filloi më 5 qershor të këtij viti, e cila është shembulli më i mirë dhe dëshmi se anëtarësimi në NATO është siguri për Malin e Zi. Mali i Zi do të vazhdojë të kontribuojë me pjesëmarrje ushtarake në misionet ndërkombëtare në Afganistan, dhe së shpejti përmes pjesëmarrjes së dy oficerëve në misionin e NATO-s në Kosovë-KFOR, përfundoi Perovic.

PREDRAG BOSKOVIC-UEHARA MARGARET

Shtetet e Bashkuara-aleati strategjik kryesor i Malit të Zi

Ministri i Mbrojtjes, Z. Predrag Boskovic, u takua më 19 korrik me ambasadorin amerikan në Mal të Zi, Uehara Margaret (Margaret Uehara), si pjesë e vizitës së tij të lamtumirës në Ministrinë e Mbrojtjes të Malit të Zi.

Ministri Boskovic falënderoi për kontributin e tyre në reformën e përgjithshme të Ambasadës Amerikane në Mal të Zi gjatë afatit të AL Uehara. Ai theksoi mbështetjen e fuqishme të aspiratave euroatlantike të Malit të Zi për të ndihmuar në plotësimin e parakushteve të nevojshme, të cilat rezultuan në anëtarësimin e plotë të vendit tonë në NATO. Në këtë drejtim, Boskovic, tha se Shtetet e Bashkuara janë aleati strategjik kryesor Malit të Zi, dhe shprehu kënaqësinë se cilësia dhe bashkëpunimi gjithëpërfshirës mbrojtjes midis dy vendeve do të vazhdojë të zhvillohet në fushat e arsimit dhe modernizimin e ushtrisë malazeze, si dhe forcimin e nivelit të



ndërveprimit në përputhje me standardet më të larta. Ministri po ashtu falënderoi ambasadorët dalëse Uehara dhe kontributin personal në zhvillimin e kapacitetit demokratik të shoqërisë malazeze, dhe në forcimin e bashkëpunimit në mes të sektorit të sigurisë dy vendeve.

Ambasadori Uehara shprehu kënaqësinë me reformat e zbatuara me sukses dhe anëtarësimin të Malit të Zi në NATO, duke theksuar se ushtarët malazezë qëndrojnë

me pjesën tjetër të aleatëve, në mënyrë aktive duke kontribuar në sigurinë globale. Duke shprehur besimin se në bashkëpunimin e ardhshëm bilateral ndërmjet dy vendeve do të vazhdojë për të nxitur, Uehara tha se Shtetet e Bashkuara do të vazhdojnë të jenë mbështetje e fuqishme për Malin e Zi në fushën e forcimit të aftësive të mbrojtjes kombëtare.

Anija shkollore e marinës italiane “Keroli” në Tivar

Me rastin e vizitës të anijes italiane “Kero”, pjesë e Marinës së Republikës së Italisë, pritja u organizua në anijen e shkollës “Jadran”, ku mori pjesë Ministri i Mbrojtjes të Malit të Zi, Predrag Boskovic, dhe ambasadorit italian në Mal të Zi, HE Luka Zelioli. Ministri Boskovic përshëndeti anëtarët e ekipazhit dhe kadetët e Akademisë Detare Italiane, dhe shprehu kënaqësinë e tij që Ministria e Mbrojtjes e Malit të Zi organizoi një bord shkollor ku kadetët e rinj ku fituan përvojën e tyre të parë detare. Boskovic tha se takimi i dy anijes të shkollës, ose në det ose në port, është gjithmonë një ngjarje e veçantë, sidomos kur bëhet fjalë për anijet me një histori kaq të pasur, të tilla si “Jadran” dhe “Kero”.

Ministri falënderoi Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Italisë për mbështetjen multi-vjeçare në fushën e trajnimit të kadetëve të Ushtrisë së Malit të Zi në akademitë ushtarake në Republikën e Italisë, ku vitin e kaluar oficerë të rinj, kanë përfunduar Akademinë Detare në Livorno, Lieutenant Lazar Knežić dhe Toger Corvette Sara Rakocevic. Ambasadori Zelioli falënderoi Ministrinë e Mbrojtjes së Malit të Zi për mbështetjen e përgjithshme gjatë vizitës studimore në Tivar. Ai theksoi se kjo vizitë është edhe një shembull i marrëdhënieve historike miqësore midis dy vendeve, si dhe një mundësi për të përmirësuar marrëdhëniet e ndërsjellta dhe shkëmbimin e përvojave në mes të flotave të vendeve aleate, Malit të Zi dhe Italisë. Varkë me vela “Kero” u krijua në vitin 1948, me urdhër të sipërmarrësit Ricardo dhe ajo u dhirua në vitin 1983 për të marinës italiane. Që atëherë të përdoret si një anije trajnimi e Marinës së Republikës së Italisë, dhe është e angazhuar në fushata të shumta arsimore. Një anije, e cila ishte nën komandën e toger Livia Matrušelijs, aktualisht e angazhuar në trajnimin e kadetëve të vitit të tretë në Akademinë Detare Livorno.

Diplomohen 43 kadetë të rinj

Në ambientet e Muzeut të Forcave të Armatosura të RSH, u zhvillua më 20 korrik paradite ceremonia e diplomimit të 43 kadetëve të rinj të Kursit të Përgatitjes së Oficerëve të rinj (KPOR).

Të pranishëm në ceremoni ishin ministrja e Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka, zv.shafi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjenerale brigade Manushaqe Shehu, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Bajram Begaj, komandantë forcash, deputetë të Komisionit Parlamentar të Sigurisë, drejtorë drejtorie në MM dhe SHP, ushtarakë e familjarë të të rinjve. Ministrja Xhaçka nënvizoi gjatë fjalës së saj se këta të rinj të sapo diplomuar nuk do të jenë 43 emra më shumë në organikat e Forcave të Armatosura, por do jenë 43 vajza dhe djem, të gatshëm për të qenë lider të ardhshëm të FA. "Jam këtu sot, edhe në cilësinë e ministres së Mbrojtjes, për t'ju dhënë garanci që këto hapësira që krijohen në Forcat e Armatosura janë plotësisht të mundura, të prekshme dhe të arritshme, për këdo që ka zgjedhur të bëjë karrierë dhe ti përkushtohet Forcës tonë të Armatosur", u shpreh ndër të tjera ministrja Xhaçka. Oficerët e graduar ndoqën për 24 javë Kursin e Përgatitjes së Oficerëve të rinj, pranë Forcave të Armatosura të RSH-së.

